



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI

Nr. 314/2 Prot.

Vlorë më, 05.02 2026

VENDIM

Nr. 2, datë 05.02 2026

PËR

**PROPOZIMIN NË SENATIN AKADEMIK TË "STRATEGJISË SË KËRKIMIT
SHKENCOR DHE INOVACIONIT NË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI",
VLORE 2026-2030"**

Në mbështetje të nenit 1,2,3 dhe 40 të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenit 3 dhe nenit 26, pika 3, gërma ç, të Statutit të UV-së; nenit 1 të Rregullores së Brendshme të UV-së; si dhe referuar shkresës së Drejtorisë së Kërkim-Zhvillimit dhe Marrëdhënjëve me të tretët, me Nr.319 prot, datë 05.02.2026, Rektorati në mbledhjen e datës 05.02.2026,

VENDOSI

1. Të propozojë në Senatin Akademik "Strategjinë e kërkimit Shkencor dhe inovacionin të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, për vitin 2026-2030, sipas materialit bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Vendimi përcillet për miratim të mëtejshëm në Senatin Akademik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

REKTOR E

Prof. Dr. Aurela SALIAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

**STRATEGJIA
PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE
INOVACIONIN
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
2026-2030**

Vlorë 2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

PËRMBLEDHJE

Strategjia për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë për periudhën 2026–2030 bazohet në katër boshte strategjike të zhvillimit, të cilat përbëjnë shtyllat themelore mbi të cilat ndërtohen politikat, objektivat dhe masat institucionale në fushën e kërkimit, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit.

1. *Kërkim shkencor ndërkombëtar dhe ekselencë shkencore;*
2. *Infrastrukturë dhe kapacitete kërkimore;*
3. *Kërkim shkencor i aplikuar dhe inovacion;*
4. *Rrjete kërkimore dhe mobilitet shkencor.*

Zbatimi i Strategjisë për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin 2026-2030 do të monitorohet dhe vlerësohet përmes një kornize të strukturuar institucionale, e cila bazohet në përdorimin e treguesve të matshëm të performancës (KPI) për secilin bosht strategjik dhe objektiv prioritar, në raportimin vjetor institucional të progresit të arritur, si dhe në rishikimin periodik çdo dy vjet nga strukturat drejtuese, me qëllim garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm dhe përshtatjes së strategjisë ndaj zhvillimeve të reja akademike, shkencore dhe institucionale.

Koordinimi i përgjithshëm i procesit të zbatimit do të realizohet nga Zëvendës-Rektorja për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor, në bashkëpunim të ngushtë me Sektorin e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve dhe me strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në universitet.

Ky mekanizëm koordinimi dhe monitorimi konsolidohet brenda kuadrit të organigramës zyrtare të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, e cila përcakton qartë rolet, kompetencat dhe përgjegjësitë e strukturave drejtuese, përfshirë Rektorin, Zëvendës-Rektorët dhe njësitë qendrore, si dhe modalitetet e bashkëpunimit ndërinstitucional për zbatimin efektiv të objektivave strategjike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrje
2. Konteksti dhe situata aktuale
3. Misioni, vizioni dhe vlerat në kërkim dhe inovacion
4. Vizioni strategjik
5. Boshtet, objektivat strategjike dhe linjat e veprimit

Skenari I. Kërkim shkencor ndërkombëtar dhe ekselencë shkencore

Skenari II. Infrastrukturë dhe kapacitete kërkimore

Skenari III. Kërkim shkencor i aplikuar dhe inovacion

Skenari IV. Rrjete kërkimore dhe mobilitet shkencor

Aneke

- I. Grupi i punës
- II. Metodologjia e përdorur për hartimin e strategjisë së kërkimit dhe inovacionit
- III. Monitorimi, raportimi dhe rishikimi i strategjisë
- IV. Analiza SWOT
- V. Dokumentacioni i konsultuar dhe integruar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

1. HYRJE

Më 28 shkurt 2024, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (UV) shënoi 30-vjetorin e themelimit të tij. Gjatë këtyre viteve, ky universitet është shndërruar në një forcë të rëndësishme shtytëse të zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe kulturor të qytetit të Vlorës dhe të rajonit jugor të Shqipërisë. Njëkohësisht, ai është hapur ndaj hapësirës ndërkombëtare me synimin për t'u konsoliduar si një institucion referues në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. I rrënjësor fort në realitetin lokal, por i orientuar drejt botës, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë përfaqëson sot një aktor kyç në zhvillimin rajonal.

Që në fillimet e tij, UV i ka kushtuar një rëndësi të veçantë kërkimit shkencor dhe zhvillimit akademik. Lidhja ndërmjet cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor, dhe realitetit shoqëror e ekonomik të rajonit ka qenë baza mbi të cilën institucioni është zhvilluar. Ky kombinim faktorësh reflektohet edhe në përpjekjet e vazhdueshme për rritjen e performancës akademike, pjesëmarrjen në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në përmirësimin e pozicionimit të universitetit në rrjetet akademike dhe kërkimore.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë është gjithashtu i vetëdijshëm për rolin e tij në zhvillimin lokal dhe rajonal. Angazhimi i tij ndaj shoqërisë shprehet në ofertën e gjerë të programeve Bachelor, Master dhe Doktoratë, në përgatitjen e profesionistëve të kualifikuar për tregun e punës, si dhe në transferimin e njohurive dhe inovacionit drejt komunitetit dhe sektorëve ekonomikë. Kjo lidhje ndërmjet mësimdhënies, kërkimit dhe realitetit socio-ekonomik kontribuon në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Në kontekstin e transformimit të paradigmes ekonomike dhe shoqërore, ku njohuria dhe inovacioni janë shndërruar në faktorë kryesorë të zhvillimit, universitetet luajnë një rol qendror në krijimin e kapitalit njerëzor dhe në gjenerimin e dijes. Si institucion i arsimit të lartë publik, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë mban një përgjegjësi shoqërore në rritje, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor të vendit.

Ky Plan Strategjik synon të forcojë misionin e UV-së, të bazuar në ekselencën akademike dhe shkencore, për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve, për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të pozicionuar Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë si një qendër reference për arsimin, kërkimin dhe inovacionin në nivel kombëtar dhe rajonal.

Strategjia e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit 2026-2030 e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë (UV) përbën dokumentin kryesor orientues për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore dhe inovative



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

të institucionit në një kontekst të ri shoqëror, ekonomik dhe teknologjik, të karakterizuar nga transformime të thella dhe rritje e rolit të dijes si faktor kyç i zhvillimit të qëndrueshëm.

Strategjia është ndërtuar në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional 2026-2030 të UV-së, me kuadrin ligjor kombëtar për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, si dhe me prioritetet e Zonës Evropiane të Kërkimit (European Research Area – ERA) dhe politikat e Bashkimit Evropian në fushën e kërkimit dhe inovacionit.

Vizioni i kësaj strategjie është konsolidimi i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë si një universitet kërkimor dhe inovativ, me profil të dallueshëm shkencor dhe dukshmëri ndërkombëtare, i integruar në rrjetet evropiane të kërkimit dhe i angazhuar ndaj sfidave shoqërore dhe zhvillimit rajonal.

2. KONTEKSTI DHE SITUATA AKTUALE

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ofron shërbimin publik të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor përmes mësimdhënies, kërkimit dhe transferimit të njohurive, duke u siguruar anëtarëve të komunitetit universitar, organizatave dhe shoqërisë në tërësi aftësitë, idetë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të jetuar dhe punuar në një realitet që karakterizohet nga ndryshime të vazhdueshme shoqërore, ekonomike dhe teknologjike.

Në kontekstin e zhvillimit institucional, strategjia e fundit institucionale e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë është hartuar për periudhën 2017-2022, duke përfaqësuar dokumentin bazë orientues për politikat akademike, kërkimore dhe organizative të universitetit në atë fazë. Pas përfundimit të kësaj periudhe strategjike, UV përballet me nevojën për një qasje të re dhe të përditësuar, në përputhje me transformimet e arsimit të lartë në nivel kombëtar dhe evropian, si dhe me prioritetet e reja të zhvillimit socio-ekonomik të vendit.

Që nga themelimi i tij, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë i ka kushtuar një rëndësi të veçantë kërkimit shkencor si komponent thelbësor i misionit të tij akademik. Lidhja ndërmjet cilësisë së mësimdhënies, prodhimit të dijes shkencore dhe realitetit socio-ekonomik të rajonit ka qenë baza mbi të cilën institucioni është zhvilluar dhe konsoliduar. Kjo qasje synon jo vetëm avancimin akademik, por edhe rritjen e ndikimit të universitetit në zhvillimin lokal dhe rajonal, përmes ofrimit të zgjidhjeve shkencore për sfidat konkrete të shoqërisë.

Në këtë kuadër, Universiteti ka ndjekur një qasje të dyfishtë strategjike. Nga njëra anë, një pozicionim horizontal, që synon garantimin e cilësisë shkencore në shumicën e fushave të kërkimit, duke i bërë ato konkurruese në nivel kombëtar dhe rajonal. Nga ana tjetër, një pozicionim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

vertikal, që synon zhvillimin dhe konsolidimin e fushave prioritare të kërkimit, me potencial për të arritur nivele ekselence dhe njohjeje ndërkombëtare në afatmesëm dhe afatgjatë.

Në bazë të këtij vizioni, janë zhvilluar politika dhe programe institucionale që synojnë forcimin e kapaciteteve kërkimore, rritjen e pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ndërtimin e partneriteteve strategjike me universitete, qendra kërkimore, institucione publike dhe sektorin privat. Paralelisht, përfshirja e stafit akademik me profile të reja dhe të larmishme ka kontribuar në zgjerimin e fushave të kërkimit dhe në rritjen e pranisë së UV-së në rrjete dhe platforma akademike ndërkombëtare.

Duke qenë e vetëdijshme për rëndësinë themelore të burimeve njerëzore, UV synon të forcojë politikat për zhvillimin e karrierës akademike, tërheqjen dhe mbajtjen e talenteve kërkimore, si dhe krijimin e kushteve të favorshme për realizimin e veprimtarisë shkencore. Këto masa synojnë rritjen progresive të mbështetjes për kërkimin, si në aspektin e kapaciteteve njerëzore, ashtu edhe të burimeve infrastrukturore dhe financiare.

Në një kontekst më të gjerë, transformimi i shoqërisë drejt një ekonomie të bazuar në njohuri, inovacion dhe teknologji, ka rritur ndjeshëm rolin dhe përgjegjësinë shoqërore të universiteteve. Në këtë kuadër, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë synon të pozicionohet si një aktor kyç në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor të rajonit dhe të vendit, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt së ardhmes.

Partneritetet dhe profilizimi strategjik ndërkombëtar

Forcimi i ndërkombëtarizimit të veprimtarisë kërkimore të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë (UV) mbështetet gjithnjë e më shumë në tregues të jashtëm të njohur ndërkombëtarisht, të cilët reflektojnë rritjen e performancës shkencore dhe pozicionimin e universitetit në hapësirën akademike kombëtare dhe ndërkombëtare. Prodhimi shkencor i stafit akademik evidentohet përmes publikimeve të indeksuara në Scopus dhe Web of Science, të cilat janë të pasqyruara në mënyrë transparente në faqen zyrtare të universitetit dhe përfaqësojnë një tregues të drejtpërdrejtë të cilësisë dhe impaktit të kërkimit shkencor të UV-së. Në këtë kuadër, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë renditet në mënyrë të qëndrueshme ndër institucionet kërkimore më aktive në vend. Sipas Albanian National H-index Ranking, në vitin 2025 UV renditet në vendin e 8-të në rang kombëtar, duke u bazuar në H-indeksin e përgjithshëm të institucioneve shkencore në Shqipëri, i cili llogaritet mbi të dhënat e platformave shkenometrike ndërkombëtare si Scopus, Web of Science dhe Google Scholar. Ky tregues konfirmon rritjen e vazhdueshme të ndikimit shkencor të universitetit në nivel kombëtar. Ndërkombëtarizimi institucional i UV-së përforcohet gjithashtu nga pajisja me Erasmus Charter for Higher Education (ECHE) 2021–2027, e cila garanton përfshirjen e universitetit në programet evropiane të mobilitetit dhe bashkëpunimit akademik, si



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

dhe nga pjesëmarrja aktive në programin Erasmus+ për shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik.

Instrumentet kryesore për realizimin e këtij boshti përfshijnë:

- marrëveshje bilaterale dhe multilaterale kërkimore;
- pjesëmarrje në programe Horizon Europe, COST, Erasmus+;
- thithje të profesorëve vizitorë dhe ekspertëve ndërkombëtarë;
- mobilitete kërkimore për staf dhe doktorantë;
- bashkëpunime me diasporën akademike shqiptare;
- përdorim strategjik i ranking-eve dhe platformave digjitale për promovimin institucional.

Një tregues domethënës i dukshmërisë ndërkombëtare të universitetit është edhe renditja nr. 1 në botë për "Student Mobility and Openness" sipas WURI Ranking 2024, e cila vlerëson institucionet e arsimit të lartë për hapjen ndërkombëtare, mobilitetin dhe përfshirjen globale të studentëve.

Kjo renditje e pozicionon Universitetin "Ismael Qemali" Vlorë si një aktor të spikatur në fushën e ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë. Po ashtu, universiteti renditet ndër institucionet më të mira shqiptare sipas Webometrics Ranking of World Universities, i cili mat praninë, dukshmërinë dhe ndikimin akademik të institucioneve në hapësirën digjitale globale.

Ky vlerësim reflekton jo vetëm performancën kërkimore, por edhe angazhimin e universitetit në promovimin e dijes dhe transparencës akademike në nivel ndërkombëtar. Në tërësi, këta tregues dëshmojnë se Universiteti "Ismael Qemali" Vlorë po konsolidohet gradualisht si një institucion me dukshmëri ndërkombëtare, i mbështetur në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor, forcimin e partneriteteve strategjike dhe pjesëmarrjen aktive në rrjetet evropiane dhe globale të arsimit të lartë.

Në kuadër të këtij boshti strategjik, Universiteti "Ismael Qemali" Vlorë synon:

- të forcojë pozicionimin e tij si partner i besueshëm kërkimor në hapësirën evropiane të kërkimit (ERA);
- të rrisë pjesëmarrjen aktive në konsorciume ndërkombëtare kërkimore;
- të zhvillojë profile të dallueshme shkencore (research niches) në fushat e specializimit;
- të konsolidojë brand-in institucional të UV-së si qendër ekspertize rajonale dhe ndërkombëtare.

Qasje të reja ndaj sfidave të reja

Konteksti i jashtëm po përjeton ndryshime të thella në të gjitha nivelet: në nivel sistematik, organizativ dhe në proceset e funksionimit. Realiteti aktual është thelbësisht i ri dhe kërkon përgjigje të reja. Për këtë arsye, një pjesë e konsiderueshme e transformimeve që po ndodhin kërkojnë reagime të reja nga sistemi shkencor, teknologjik dhe i inovacionit, dhe në mënyrë të veçantë nga universitetet, si aktorë kyç të zhvillimit shoqëror dhe ekonomik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Këto ndryshime shoqërohen me sfida të reja lokale dhe globale, të cilat janë gjithnjë e më të ndërlikdhura me njëra-tjetrën. Nga perspektiva e sfidave globale, një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet shtatëmbëdhjetë Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) të miratuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara në vitin 2015, të cilat përbëjnë një kuadër referues ndërkombëtar për politikatat e zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor.

Në këtë kontekst, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë duhet të pranojë dhe të forcojë angazhimin e tij ndaj shoqërisë, duke luajtur një rol proaktiv në nxitjen e kërimit shkencor që ofron njohuri, zgjidhje dhe evidenca për përballimin e këtyre sfidave globale dhe lokale.

Modelet tradicionale të gjenerimit dhe transferimit të dijes po transformohen gradualisht drejt sistemeve më të hapura dhe bashkëpunuese, të njohura si Open Science dhe Open Innovation, ku bashkëkrijimi i njohurive përbën një element thelbësor të procesit dhe një strukturë e re për krijimin e vlerës shkencore. Këto modele synojnë të rrisin përfitimin shoqëror të kërimit dhe të sigurojnë një ndikim më të gjerë dhe më gjithëpërfshirës.

Në të njëjtën kohë, komuniteti shkencor i së tashmes dhe i së ardhmes, si dhe institucionet akademike, duhet të zhvillojnë kompetenca dhe funksione të reja. Disa prej tyre janë të brendshme, si integrimi ndërdisiplinor dhe rritja e bashkëpunimit ndërmjet fushave të ndryshme të dijes, ndërsa të tjera janë të jashtme, si ndërtimi i një kulture të re ndërveprimi ndërmjet sistemit shkencor dhe atij shoqëror.

Një dimension i rëndësishëm i këtij transformimi është edhe avancimi drejt Kërimit dhe Inovacionit të Përgjegjshëm (Responsible Research and Innovation - RRI), i cili nënkupton përfshirjen aktive të shoqërisë në proceset kërkimore, promovimin e shkencës së hapur, respektimin e parimeve etike dhe garantimin e barazisë gjinore, ndër të tjera.

Plani Strategjik i Kërimit Shkencor dhe Inovacionit i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë është konceptuar pikërisht në këtë realitet të ri, ku njohuria është shndërruar në forcën kryesore shtytëse të zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, dhe synon të orientojë universitetin drejt një roli gjithnjë e më aktiv në shërbim të shoqërisë. Ky plan do të udhëheqë strategjitë dhe linjat e veprimit të UV-së në vitet në vijim, me synimin për ta konsoliduar atë si një universitet kërkimor dhe inovativ, konkurrues në nivel ndërkombëtar dhe i angazhuar ndaj sfidave bashkëkohore të shoqërisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

3. MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT NË KËRKIM DHE INOVACION

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (UV) është krijuar si institucion publik i arsimit të lartë në shërbim të shoqërisë shqiptare, mbi bazën e traditës akademike dhe strukturave ekzistuese arsimore. Që në fillimet e tij, synimi kryesor ka qenë vendosja e dijes në shërbim të shoqërisë, për të kontribuar në zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të qytetit të Vlorës, rajonit dhe më gjerë, në një kontekst që ka njohur transformime të rëndësishme ndër vite.

Misioni

Cilat janë detyrat tona kryesore në kërkim dhe inovacion?

Të kontribuojmë në përmirësimin e mirëqenies së shoqërisë dhe në zhvillimin e qëndrueshëm, veçanërisht në nivel lokal dhe rajonal, përmes gjenerimit, zhvillimit dhe transferimit të njohurive shkencore, duke mbështetur politikatat publike, sektorët ekonomikë dhe zhvillimin e komunitetit.

Vizioni

Cili është vizioni ynë në kërkim dhe inovacion?

Të konsolidohemi si një universitet kërkimor dhe inovativ me dukshmëri ndërkombëtare, i lidhur me rrjetet më të rëndësishme akademike dhe shkencore në të gjitha fushat e dijes, dhe të shndërrohem në një pikë reference kombëtare dhe rajonale për kërkimin shkencor dhe inovacionin. UV synon të jetë një universitet që formon individë të kualifikuar, zhvillon kërkim të përgjegjshëm dhe inovacion konkurrues, është i angazhuar ndaj mjedisit dhe kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit dhe të vendit.

Vlerat

Çfarë përfaqësojmë?

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë përfaqëson një komunitet akademik dhe kërkimor të hapur ndaj ndryshimit, me aftësi të lartë përshtatjeje dhe reagimi ndaj sfidave bashkëkohore, ku në qendër vendosen njeriu dhe vlerat e bashkëpunimit, besimit, përgjegjësisë së përbashkët, integritetit akademik dhe shërbimit ndaj shoqërisë.

5. VIZIONI STRATEGJIK

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (UV) synon të arrijë një sërë objektivash strategjike në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit, të cilët përbëjnë bazën e zhvillimit të tij afatgjatë:

- Të arrijë nivele të ekselencës shkencore, mbi të cilat të ndërtohen procese të avancuara të mësimdhënies dhe të nxënies, duke u ofruar studentëve formimin më të lartë cilësor dhe duke kontribuar në zhvillimin e tyre si qytetarë dhe profesionistë të përgjegjshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

- Të gjenerojë, transferojë dhe socializojë dijen, me qëllim mbështetjen e progresit të qëndrueshëm të shoqërisë. Kërkimi, transferimi i njohurive dhe mësimdhënia janë procese të pandashme, ndaj studentët në të gjitha nivelet e studimit duhet të pajisen me kompetencat e nevojshme dhe të përfshihen aktivisht në veprimtarinë kërkimore dhe inovative.
- Të pranojë dhe të ushtrojë rolin e tij si motor i zhvillimit njerëzor të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm, veçanërisht në kontekstin social, kulturor dhe ekonomik të qytetit të Vlorës dhe rajonit, përmes kërkimit të pavarur, si dhe transmetimit dhe aplikimit të njohurive. Njëkohësisht, UV synon të kontribuojë edhe në sfidat globale që prekin shoqërinë dhe planetin.
- Të shfrytëzojë universalitetin e dijes, që është thelbësor për natyrën e universitetit, si mjet komunikimi dhe dialogu ndërmjet popujve, duke nxitur në maksimum ndërkombëtarizimin e veprimtarisë universitare.

Duke marrë në konsideratë dinamikën dhe fleksibilitetin institucional, bashkëpunimet e jashtme dhe vullnetin për t'u përballur me sfidat në shërbim të shoqërisë, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë synon të konsolidohet në vitet në vijim si një mjedis lider në kërkim dhe inovacion, i cili integron modele të reja bashkëkohore për gjenerimin dhe transferimin e njohurive.

Ekosistemet e gjalla përfaqësojnë struktura funksionale komplekse, të afta për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve të pasigurta, duke vlerësuar diversitetin individual dhe duke e lidhur atë me mjedisin lokal dhe global. Në këtë kuptim, UV synon të zhvillohet si pjesë e një ekosistemi kërkimor dhe inovativ, ku:

- Kërkimi dhe inovacioni do të orientohen drejt tematikave me rëndësi shkencore dhe shoqërore, ku universiteti dhe partnerët e tij mund të kenë ndikim të ndjeshëm në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Talenti, kreativiteti dhe aftësitë profesionale do të nxiten përmes aleancave të brendshme dhe të jashtme, në kuadër të proceseve të bashkëkrijimit dhe bashkëinovacionit.
- Departamentet dhe njësitë kërkimore me performancë të lartë do të mbështeten përmes zhvillimit të kulturës organizative, lidërshiptit akademik, asistencës teknike dhe drejtuese, si dhe sigurimit të infrastrukturës së nevojshme.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë synon të maksimizojë ndikimin e tij shoqëror, ekonomik dhe kulturor përmes veprimtarisë kërkimore dhe inovative, të bazuar në ekselencën shkencore dhe të matur edhe përmes impaktit të saj, duke kontribuar drejtpërdrejt në përballimin e sfidave të shoqërisë dhe në forcimin e sektorëve produktivë ku rajoni ka potencial zhvillimi.

Sfidat shoqërore

Sfidat kryesore ndaj të cilave ky Plan Strategjik synon të japë përgjigje janë:

- Përmirësimi i mirëqenies së shoqërisë, nëpërmjet zhvillimit të politikave dhe zgjidhjeve të bazuara në evidencë shkencore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

- Zhvillimi i qëndrueshëm, në dimensionin ekonomik, social dhe mjedisor, duke promovuar modele inovative që kontribuojnë në rritjen ekonomike të balancuar, përfshirjen sociale dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Rigjallërimi i qyteteve dhe i rajonit, përmes nxitjes së inovacionit, transferimit të njohurive dhe përfshirjes aktive të universitetit në zhvillimin territorial dhe komunitar.

Fokusimi në këto sfida dhe objektiva u mundëson fushave të ndryshme shkencore të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë të përfshihen në mënyrë aktive në identifikimin dhe ndërtimin e fushave të ekselencës, duke nxitur kështu zhvillimin e projekteve ndërdisiplinore dhe krijimin e zgjidhjeve të integruara për problematikat komplekse të shoqërisë bashkëkohore.

Sektorët prodhues të specializuar të rajonit

Në bazë të strategjisë fillestare të përcaktuar në planin e parë të kërkimit shkencor, përputhur me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, si dhe me legjislacionin kombëtar për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, identifikohen sektorët e mëposhtëm të specializimit rajonal që lidhen drejtpërdrejt me profilin akademik dhe kërkimor të UV-së: ekonomi dhe menaxhim, shëndetësi dhe shërbime shëndetësore, shkenca humane dhe edukimi, si dhe teknologji dhe shkenca teknike. Fokusimi mbi këta sektorë prodhues prioritarë synon të forcojë vizionin e rajonit si një forcë shtytëse për zhvillimin e qëndrueshëm dhe për inovacionin ekonomik dhe social, duke shfrytëzuar funksionet themelore të UV-së në kërkimin shkencor dhe zhvillim, sipas dispozitave të statutit dhe rregulloreve për veprimtarinë shkencore dhe ndërkombëtarizimin e veprimtarisë së institucionit. Gjithashtu, dinamikat socio-ekonomike të rajonit mund të çojnë në shfaqjen e sektorëve të rinj të specializimit në të ardhme.

Ekselencë shkencore

Nëpërmjet ekselencës shkencore, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë kontribuon në avancimin e dijes dhe gjeneron mundësi të reja që ndihmojnë në rritjen e kapacitetit të sektorit prodhues për të inovuar dhe për të qenë konkurrues, si dhe për t'u përballur me sfidat shoqërore të trajtuara në këtë plan. Arritja e ekselencës shkencore kuptohet si një proces i përmirësimit të vazhdueshëm, i cili forcon lidhësinë shkencore dhe njohjen ndërkombëtare në fushat e specializimit. Në mbështetje të politikave institucionale për garantimin dhe rritjen e ekselencës shkencore, kjo Strategji e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit 2026–2030 synon të reflektojë angazhimin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë për të rritur cilësinë, ndikimin dhe relevancën shoqërore të veprimtarisë kërkimore, si dhe për të forcuar rolin e inovacionit si komponent thelbësor i kërkimit shkencor, duke shfrytëzuar instrumentet institucionale të universitetit dhe duke zhvilluar bashkëpunime të strukturuar me bizneset, institucionet publike dhe aktorët socio-ekonomikë të rajonit, me qëllim ndërtimin e një sistemi funksional rajonal të kërkimit, dijes dhe inovacionit, i cili kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm dhe në përmirësimin e mirëqenies së komunitetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

Tabela përmbledhëse e treguesve strategjikë

Boshti strategjik	KPI kryesor
<i>Skenari I - Ekselencë dhe ndërkombëtarizim</i>	Publikime Scopus/WoS, H-index, Projekte Horizon
<i>Skenari II – Infrastrukturë</i>	Laboratorë të akredituar, Repository, Revista UVSJ me faktor impakti të lartë
<i>Skenari III – Inovacion</i>	Patenta, spin-off, kontrata kërkimi
<i>Skenari IV – Rrjete dhe mobilitet</i>	Mobilitete, marrëveshje, ekspertë të ftuar

5. BOSHTET, OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE LINJAT E VEPRIMIT

Strategjia e Kërkimit Shkencor e Universitetit “Ismael Qemali” Vlorë bazohet në katër skenarë zhvillimi:

- (I) Ekselencë dhe ndërkombëtarizim shkencor,
- (II) Infrastrukturë dhe kapacitete kërkimore,
- (III) Kërkim i aplikuar dhe inovacion,
- (IV) Rrjete dhe mobilitet kërkimor, të cilët janë të lidhur drejtpërdrejt me objektivat kombëtare të AKKSHI dhe prioritetet e Zonës Europiane të Kërkimit.

5.1 Roadmap i zbatimit 2026-2030

Roadmap-i i zbatimit paraqet planifikimin kohor të objektivave strategjike kryesore të Universitetit “Ismael Qemali” Vlorë për periudhën 2026-2030, duke siguruar një qasje progresive dhe të matshme për realizimin e tyre.

Objektivi strategjik	2026	2027	2030
<i>Publikime Scopus/WoS</i>		+20%	+50%
<i>Projekte Horizon/COST</i>		+20%	+50%
<i>Laboratorë të akredituar</i>	0	+50%	+100%
<i>Mobilitete kërkimore</i>		+30%	+60%
<i>Spin-off akademike</i>	0	+	++
<i>% Open Access</i>	10%	30%	60%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Roadmap-i do të shërbejë si instrument bazë për monitorimin vjetor të progresit dhe për përditësimin periodik të objektivave strategjikë, në funksion të performancës institucionale dhe kushteve të mjedisit të jashtëm.

LIDHJA E SKENARËVE ME OBJEKTIVAT KOMBËTARE (AKKSHI)

	<i>Skenarët UV</i>
<i>Cilësi dhe ekselencë shkencore</i>	Skenari I
<i>Infrastrukturë kërkimore</i>	Skenari II
<i>Inovacion dhe transferim teknologjie</i>	Skenari III
<i>Bashkëpunim dhe rrjete</i>	Skenari IV
<i>Zgjidhje problemesh reale</i>	Skenari III
<i>Integrim në ERA</i>	Skenari I & IV

SKENARI I: KËRKIM SHKENCOR NDËRKOMBËTAR DHE EKSELENCA SHKENCORE

Qëllimi Strategjik

Rritja e cilësisë dhe ndërkombëtarizimit të kërimit shkencor përmes publikimeve, projekteve dhe rrjeteve kërkimore europiane.

Objektivat 1.1

- Pjesëmarrja në konsorciume/aleanca kërkimore ndërkombëtare
- Rritja e publikimeve në revista Scopus/WoS
- Pjesëmarrje aktive në projekte Horizon, COST, Erasmus+
- Organizimi i konferencave dhe workshop-eve shkencore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

- Fuqizimi i revistës UniVlora Scientific Journal

Linjat e kërkimit

1. Pjesëmarrja në konsorciume kërkimore ndërkombëtare

- Kërkime mbi modele efektive të bashkëpunimit ndëruniversitar dhe ndërdisiplinor në nivel evropian.
- Studime mbi mekanizmat e ndërtimit dhe menaxhimit të konsorciumeve kërkimore ndërkombëtare.
- Analiza e praktikave më të mira për rritjen e rolit të universiteteve periferike në projekte të mëdha kërkimore.

2. Rritja e publikimeve në revista të indeksuara Scopus / Web of Science

- Kërkime mbi cilësinë e prodhimit shkencor, standardet e publikimit dhe etikën akademike.
- Studime mbi strategjitë për rritjen e citueshmërisë dhe impaktit shkencor të publikimeve.
- Analiza bibliometrike e performancës kërkimore të stafit akademik dhe njësive kërkimore.

3. Pjesëmarrje aktive në projekte Horizon Europe, COST dhe Erasmus+

- Kërkime mbi politikat evropiane të kërkimit, inovacionit dhe arsimit të lartë.
- Studime mbi ndërlidhjen e kërkimit shkencor me zhvillimin rajonal, inovacionin dhe transferimin e njohurive.
- Analiza e ndikimit të projekteve ndërkombëtare në kapacitetet kërkimore institucionale.

4. Organizimi i konferencave dhe workshop-eve shkencore ndërkombëtare

- Kërkime mbi rolin e eventeve shkencore në ndërtimin e rrjeteve kërkimore dhe bashkëpunimeve afatgjata.
- Studime mbi format inovative të konferencave akademike dhe shkëmbimin e njohurive.
- Analiza e ndikimit të konferencave në rritjen e dukshmërisë ndërkombëtare të institucionit.

5. Fuqizimi i UniVlora Scientific Journal

- Kërkime mbi politikat editoriale, menaxhimin e revistave shkencore dhe standardet ndërkombëtare të indeksimit.
- Studime mbi ndërkombëtarizimin e bordeve editoriale dhe procesin e peer-review.
- Analiza e rolit të revistës institucionale në promovimin e kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Tregues performance (KPI)

Treguesit e Performancës për Skenarin I përfshijnë: numrin e publikimeve shkencore të indeksuara në Scopus dhe Web of Science; H-indeksin institucional; numrin e projekteve kërkimore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

ndërkombëtare të fituara (Horizon Europe, COST, Erasmus+); numrin e aplikimeve në thirrje konkurruese ndërkombëtare; numrin e konsorciumeve kërkimore ndërkombëtare ku Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë është partner ose koordinator; numrin e konferencave dhe workshop-eve shkencore ndërkombëtare të organizuara; si dhe numrin e artikujve të botuar në revistën institucionale *UniVlora Scientific Journal/Buletin Shkencor*.

- Numri i publikimeve Scopus/WoS / vit
- H-index institucional
- Numri i projekteve Horizon/COST të fituara
- Numri i konferencave ndërkombëtare
- Numri artikuj në UniVlora Scientific Journal/Buletin

SKENARI II: INFRASTRUKTURË DHE KAPACITETE KËRKIMORE

Qëllimi Strategjik

Ndërtimi i një ekosistemi modern kërkimor përmes laboratorëve, revistave shkencore, infrastrukturës digjitale dhe kapaciteteve njerëzore.

Objektivat 2.1

- Akreditimi dhe licencimi i laboratorëve kërkimorë
- Certifikime ISO për njësi kërkimore
- Indeksi i UniVlora Scientific Journal në Scopus, WoS, PubMed
- Zgjerimi i UniVlora Research Repository
- Sisteme bibliometrike për matjen e performancës
- Trajnime për metodologji kërkimi

Linjat e kërkimit

Akreditimi dhe licencimi i laboratorëve kërkimorë

- Studime mbi standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për akreditimin e laboratorëve kërkimorë.
- Kërkime mbi menaxhimin e cilësisë laboratorike, sigurinë dhe etikën në kërkim shkencor.
- Modele të organizimit dhe funksionimit të laboratorëve universitarë kërkimorë sipas praktikave më të mira evropiane.

2. Certifikimet ISO për njësi kërkimore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- Kërkime mbi implementimin e standardeve ISO (ISO 9001, ISO 17025, ISO 21001) në institucione të arsimit të lartë.
 - Analiza e ndikimit të sistemeve të menaxhimit të cilësisë në performancën kërkimore dhe inovacion.
 - Studime krahasuese mbi praktikën e certifikimit në universitete evropiane dhe rajonale.
- 3. Indeksimi i *UniVlora Scientific Journal* në Scopus, Web of Science dhe PubMed**
- Studime mbi politikat editoriale, etikën e publikimit dhe standardet ndërkombëtare të revistave shkencore.
 - Kërkime mbi rritjen e cilësisë së publikimeve, citueshmërisë dhe impaktit shkencor.
 - Analiza bibliometrike dhe scientometrike e prodhimit shkencor institucional dhe ndërkombëtar.
- 4. Zgjerimi i *UniVlora Research Repository***
- Kërkime mbi Open Science, Open Access dhe menaxhimin e të dhënave kërkimore (Research Data Management).
 - Modele për arkivimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e prodhimit shkencor institucional.
 - Studime mbi ndërveprueshmërinë e repositorëve institucionalë me platformat ndërkombëtare kërkimore.
- 5. Sisteme bibliometrike për matjen e performancës kërkimore**
- Zhvillimi dhe aplikimi i indikatorëve bibliometrikë dhe altmetrikë për vlerësimin e performancës kërkimore.
 - Kërkime mbi politikat institucionale të vlerësimit të stafit akademik dhe njësive kërkimore.
 - Analiza e përdorimit të sistemeve të inteligjencës së të dhënave për vendimmarrje strategjike në kërkim shkencor.

Tregues të performancës (KPI)

Treguesit e Performancës për Skenarin II përfshijnë: numrin e laboratorëve të akredituar dhe të modernizuar; numrin e certifikimeve ISO për njësitë kërkimore; ekzistencën dhe përdorimin e *UniVlora Research Repository*; përqindjen e publikimeve Open Access; numrin e stafit dhe doktorandëve të trajnuar në metodologji kërkimi; ekzistencën e sistemit bibliometrik institucional dhe raportimin vjetor të performancës kërkimore; si dhe buxhetin vjetor të dedikuar për infrastrukturën kërkimore.

1. Infrastrukturë laboratorike

- Numri i laboratorëve të akredituar / licencuar
- Numri i laboratorëve të modernizuar
- Përqindja e pajisjeve laboratorike të rinovuara
- Numri i certifikimeve ISO (ISO 9001, ISO 17025, etj.)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

2. Infrastrukturë digjitale kërkimore

- Ekzistenca e UniVlora Research Repository (po/jo)
- Nr. publikimeve të depozituara në repository
- % e publikimeve Open Access
- Nr. databazave shkencore me akses institucional

3. Kapacitete njerëzore kërkimore

- Nr. stafit akademik të trajnuar në metodologji kërkimi
- Nr. trajnimeve për shkrim shkencor dhe menaxhim projektsh
- Nr. doktorandëve të përfshirë në projekte kërkimore
- Nr. stafit të certifikuar në menaxhim projektsh (Horizon/IPA)

4. Performancë dhe monitorim shkencor

- Ekzistenca e sistemit bibliometrik institucional
- Raport vjetor i performancës kërkimore (po/jo)
- Nr. indikatorëve të monitoruar (publikime, projekte, citime)
- Frekuenca e raportimit (vjetor / semestral)

5. Financim dhe burime

- Buxheti vjetor për infrastrukturë kërkimore
- Shuma e fondeve të investuara në pajisje
- Nr. projekteve të infrastrukturës të financuara (AKKSHI/BE)
- % e buxhetit institucional për kërkim

	<i>KPI</i>	<i>2026</i>	<i>2030</i>
1.	Laboratorë të akredituar	1 (proces)	5
2.	Publikime në repository	0	500
3.	Staf i trajnuar	20	80
4.	% Open Access	10%	60%
5.	Buxhet kërkim	2%	5%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

SKENARI III: KËRKIM SHKENCOR I APLIKUAR DHE INOVACION

Qëllimi Strategjik

Orientimi i veprimtarisë kërkimore të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë drejt zgjidhjes së problemeve reale shoqërore dhe ekonomike, përmes zhvillimit të kërkimit të aplikuar dhe forcimit të mekanizmave të transferimit të teknologjisë, në bashkëpunim me sektorin publik, privat dhe aktorët e inovacionit, me synim rritjen e ndikimit shoqëror dhe ekonomik të universitetit.

Objektivat 3.1

- projekte pilot me bashki/industri
- studime impakti për politika publike
- patenta / prototipe
- spin-off akademike
- kontrata kërkimi me biznese

Linjat e kërkimit

- Mjedisë & biodiversiteti
- Bujqësia & bioteknologjia
- Shëndeti & mjekësia
- TIK & inteligjenca artificiale
- Uji dhe energjia
- Digjitalizimi & tranzicioni jeshil
- Shkencat sociale & humane

Treguesit e performances (KPI)

Nr.	Tregues performance
1	Projekte kërkimore të aplikuara me bashki/biznese
2.	Kontrata kërkimi me institucione publike/privat
3.	Studime impakti për politika publike
4.	Patenta / prototipe të zhvilluara
5.	Spin-off dhe start-up akademike të krijuara
6.	Produkte ose shërbime inovative të transferuara
7.	Projekte Universitet-Biznes (AKKSHI/IPA)
8.	Të ardhura nga kontrata kërkimi dhe shërbime



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

SKENARI IV: RRJETE KËRKIMORE DHE MOBILITET SHKENCOR

Qëllimi Strategjik

Integrimi i stafit dhe doktorantëve në rrjete kërkimore europiane.

Objektivat 4.1

- Mobilitete kërkimore COST, Marie Curie
- Thithje ekspertësh ndërkombëtarë
- Mentorim për kërkuesit e rinj
- Mobilitet kërkimor
- Rrjete shkencore
- Bashkëpunime me diaspora akademike
- Mentorim dhe zhvillim karriere

Linjat e kërkimit

- Promovimi i rezultateve kërkimore në media dhe platforma digjitale;
- Krijimi i podcast-eve, revistave dhe portaleve shkencore;
- Organizimi i eventeve publike shkencore (open days, science cafés);
- Forcimi i brandit institucional të UV-së si qendër ekspertize.

Treguesit e Performancës (KPI)

Nr. Tregues performance

1. Marrëveshje dhe partneritete kërkimore ndërkombëtare aktive
2. Rrjete kërkimore europiane ku UV është anëtar (COST, rrjete tematike)
3. Mobilitete kërkimore për staf akademik
4. Mobilitete kërkimore për doktorantë
5. Kërkues dhe ekspertë ndërkombëtarë të ftuar në UV
6. Programe mentorimi për kërkuesit e rinj
7. Bashkëpunime me diasporën akademike
8. Evente shkencore publike dhe aktivitete promovuese



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

ANEKSET

ANEKS I

I. GRUPI I PUNËS

Frosina Londo	Zëvendësrektore për kërkimin shkencor
Artemida Luçaj	Përgjegjëse e sektorit të kërkimit shkencor & projekteve
Rezarta Sinanaliaj	Specialiste projektesh
Miranda Pajo	Specialiste e aktiviteteve shkencore
Erik Kushta	Student

**II. METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR HARTIMIN E STRATEGJISË SË
KËRKIMIT DHE INOVACIONIT**

Hartimi i Strategjisë së Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit 2026-2030 të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë është realizuar mbi bazën e një metodologjie të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse, e cila synon të sigurojë koherencë të plotë me Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional 2026-2030, si dhe përputhshmëri me kuadrin ligjor kombëtar dhe politikat evropiane në fushën e arsimit të lartë, kërkimit dhe inovacionit. Procesi i hartimit është mbështetur në analizën e dokumenteve strategjike dhe normative kombëtare dhe evropiane, në konsultimin me strukturat drejtuese, fakultetet, departamentet dhe njësitë kërkimore të universitetit, si dhe në përdorimin e analizës SWOT për identifikimin e kapaciteteve të brendshme dhe sfidave të mjedisit të jashtëm. Në të njëjtën kohë, procesi është mbështetur edhe në analizën e treguesve sasiorë të performancës kërkimore të universitetit, përfshirë numrin e publikimeve të indeksuara në Scopus dhe Web of Science, pjesëmarrjen në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, mobilitetet akademike, H-indeksin institucional dhe burimet financiare për kërkimin shkencor, me qëllim ndërtimin e objektivave dhe treguesve të performancës (KPI) mbi baza reale dhe të matshme. Strategjia është ndërtuar gjithashtu duke u mbështetur në benchmarking me praktikatat më të mira evropiane, përmes analizës dhe krahasimit të strategjive të kërkimit dhe inovacionit të universiteteve partnere në Bashkimin Evropian dhe rajon, me synim përafrimin e politikave institucionale të UV-së me standardet e Zonës Evropiane të Kërkimit (ERA).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Një komponent i rëndësishëm i metodologjisë ka qenë edhe përfshirja e aktorëve të jashtëm (stakeholders), përfshirë institucione publike, biznese, organizata dhe partnerë akademikë, me qëllim orientimin e veprimtarisë kërkimore drejt nevojave reale të zhvillimit lokal dhe rajonal. Strategjia është ndërtuar mbi qasjen me skenarë zhvillimi të përcaktuar në Planin Institucional (Ndërkombëtarizimi, Universitet SMART, Leader Profesional dhe UV si Qendër Zhvillimi Rajonal), duke siguruar gjurmueshmëri dhe koherencë strategjike ndërmjet dokumenteve institucionale. Në të njëjtën kohë, metodologjia është orientuar drejt ndikimit shoqëror të kërkimit dhe inovacionit, duke promovuar parimet e Open Science, Responsible Research and Innovation (RRI) dhe bashkëpunimit me aktorët e jashtëm, me qëllim që kërkimi shkencor të shërbejë si instrument zhvillimi ekonomik, social dhe territorial për rajonin dhe shoqërinë në tërësi.

ANEKSI II – MATRICA E MENAXHIMIT TË RREZIKUT

Matrica e menaxhimit të rrezikut

Rreziku kryesor	Probabiliteti	Ndikimi	Masa parandaluese
Mungesë fondesh për kërkim	Lartë	Lartë	Diversifikim burimesh (Horizon, IPA, AKKSHI)
Brain drain i stafit	Mesëm	Lartë	Incentiva financiare dhe karrierë
Kapacitete të ulëta kërkimore	Mesëm	Mesëm	Trajnime dhe mentorim
Infrastrukturë e pamjaftueshme	Mesëm	Lartë	Investime dhe projekte infrastrukturore
Ndëryshime politike/ligjore	Ulët	Mesëm	Përshtatje strategjike

III. MONITORIMI, RAPORTIMI DHE RISHIKIMI I STRATEGJISË

Në zbatim të kësaj Strategjie, monitorimi, vlerësimi dhe raportimi i progresit do të realizohen në mënyrë të strukturuar dhe periodike nga strukturat përkatëse institucionale, në përputhje me kompetencat dhe detyrat funksionale të miratuara në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.

Konkretisht, përgjegjësinë kryesore për koordinimin dhe ndjekjen e zbatimit të Strategjisë e mban Zëvendës-Rektori për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kërkim-Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me të Tretët, përmes Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, i cili siguron mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, monitorimin e treguesve të performancës (KPI), si dhe përgatitjen e raporteve periodike të progresit.


Procesi i raportimit institucional mbështetet gjithashtu nga Drejtoria e Shërbimeve Ndihmëse Akademike, përmes Sektorit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit, si dhe nga strukturat përgjegjëse për raportim dhe statistika, të cilat garantojnë përputhshmërinë e zbatimit të Strategjisë me standardet e sigurimit të cilësisë, kërkesat e ASCAL dhe kuadrin ligjor kombëtar në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Raportet vjetore mbi progresin e zbatimit të Strategjisë për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin i paraqiten Rektoratit dhe Senatit Akademik, në cilësinë e organeve më të larta drejtuese dhe vendimmarrëse të institucionit, të cilat ushtrojnë funksionin e mbikëqyrjes strategjike dhe miratojnë masat korrigjuese në rast të devijimeve nga objektivat dhe treguesit e përcaktuar.



Rishikimi periodik

Rishikimi i strategjisë do të realizohet në mënyrë periodike çdo dy vjet, përmes një procesi të strukturuar vlerësimi të brendshëm, i cili përfshin analizën e arritjes së KPI-ve, konsultimin me njësitë akademike dhe aktorët e jashtëm, si dhe miratimin e rekomandimeve për përmirësim nga Senati Akademik.

Grup Monitorimi

Për zbatimin operacional të strategjisë mund të ngrihet një Grup i Përhershëm Monitorimi, i përbërë nga përfaqësues të Rektoratit, Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, Sektorit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe përfaqësues të fakulteteve, i cili do të mbështesë procesin e monitorimit dhe do të propozojë masa përmirësuese.

Menaxhimi

Monitorimi i treguesve të performancës do të mbështetet edhe nga zhvillimi gradual i një sistemi digjital (dashboard institucional), i cili mundëson mbledhjen, vizualizimin dhe analizën në kohë reale të të dhënave kërkimore.

Menaxhimi i rrezikut



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Gjatë zbatimit të strategjisë do të aplikohet një qasje e menaxhimit të rrezikut (risk management), e cila synon identifikimin dhe adresimin e rreziqeve kryesore që lidhen me financimin, burimet njerëzore, kapacitetet infrastrukturore dhe ndryshimet në politikat publike.

Lidhja me planifikimin buxhetor

Zbatimi i objektivave strategjikë do të mbështetet përmes planifikimit vjetor buxhetor të universitetit, duke siguruar lidhjen ndërmjet prioritetëve strategjike të kërkimit dhe alokimit të burimeve financiare në nivel institucional, në përputhje me buxhetin vjetor dhe planifikimin afatmesëm të zhvillimit të universitetit.

Transparenca dhe komunikimi publik

Rezultatet e monitorimit dhe raportimit vjetor do të publikohen në faqen zyrtare të universitetit dhe në raportet institucionale, në kuadër të politikave të transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së hapur.

Ndikimi shoqëror

Vlerësimi i strategjisë nuk do të kufizohet vetëm në tregues sasiorë, por do të përfshijë edhe analizën e ndikimit shoqëror, ekonomik dhe territorial të veprimtarisë kërkimore të universitetit.

Boshti UV	ERA Priority
Partneritete dhe profilizim ndërkombëtar	Deepening a truly functioning ERA
Infrastrukturë kërkimore	Research infrastructures
Kërkim i aplikuar	Knowledge valorisation
Rrjete dhe mobilitet	Researchers mobility



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

IV. ANALIZA SWOT - KËRKIMI SHKENCOR DHE INOVACIONI (UV 2026–2030)

PIKAT E FORTA (Strengths)	PIKAT E DOBËTA (Weaknesses)
Strukturë organizative funksionale për menaxhimin e kërkimit dhe projekteve	Numër i ulët i programeve të studimit në gjuhë të huaj
Staf akademik i kualifikuar me grada shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare	Numër i kufizuar i programeve të përbashkëta ndërkombëtare
Pjesëmarrje aktive në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare (Erasmus+, IPA, Horizon)	Infrastrukturë kërkimore dhe laboratorike e pamjaftueshme
Marrëdhënie të konsoliduara me institucione publike dhe sektorin privat	Mungesë financimi të qëndrueshëm për kërkimin shkencor
Bashkëpunime intensive me universitete të BE-së dhe rajonit	Nivel i ulët i aplikimeve në projekte Horizon Europe
Akses në programe europiane si EUSAIR dhe ekonomi blu	Aftësi të kufizuara në shkrim shkencor dhe menaxhim projektesh
Përdorim në rritje i teknologjisë digjitale në menaxhim dhe mësimdhënie	Rrjedhje e stafit të kualifikuar drejt institucioneve të tjera
Politika institucionale për cilësi dhe vlerësim akademik	Pajisje shkencore dhe laboratorike të amortizuara
Diversitet i fushave kërkimore sipas profileve të katër fakulteteve	Ndërdisciplinaritet i dobët ndërmjet fakulteteve
Pozicion gjeografik strategjik dhe potencial rajonal	Numër i ulët studentësh të përfshirë në kërkim shkencor
MUNDËSITË (Opportunities)	KËRCËNIMET (Threats)
Thirrje financimi nga BE (Horizon Europe, COST, Erasmus+, IPA)	Reduktim i fondeve publike për arsimin dhe kërkimin
Politikat kombëtare për Smart Specialisation	Konkurrencë e fortë nga universitete të tjera
Bashkëpunime me industri, turizëm, shëndetësi, ekonomi blu	Brain drain i kërkuesve të rinj
Open Science dhe digjitalizimi	Plakje e stafit akademik
Rritja e kërkesës për studime të aplikuara rajonale	Mungesë e stafit të ri kërkimor
Ranking-e ndërkombëtare dhe benchmarking	Mungesë e kulturës së inovacionit në biznes
Programet për Gender Equality, Green Deal	Paqëndrueshmëri ekonomike dhe politike
Zhvillimi i start-up dhe spin-off universitare	Varësi nga tarifat e studentëve
Partneritete me bashki dhe institucione publike	Ulje e interesit të maturantëve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

V. DOKUMENATACIONI I KONSULTUAR DHE INTEGRUAR

Dokumente kombëtare

1. Ministria e Arsimit dhe Sportit (2023). *Draft Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030*, Tiranë.
2. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (2015). *Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor"*.
3. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit – AKKSHI. *Programet kombëtare të financimit për kërkimin dhe inovacionin*.

Dokumente institucionale UV

4. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (2025). *Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2025–2030*.
5. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (2022). *Strategjia e Ndërkombëtarizimit 2022–2027*.
6. Statuti dhe Rregulloret e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Dokumente evropiane / ndërkombëtare

7. European Commission (2021). *Horizon Europe Framework Programme 2021–2027*.
8. European Commission. *European Research Area (ERA) Policy Agenda*.
9. United Nations (2015). *Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development (SDGs)*.
10. OECD. *University Research and Innovation Policy Frameworks*.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

**STRATEGJIA
PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE
INOVACIONIN
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
2026-2030**

Vlorë 2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

PËRMBLEDHJE

Strategjia për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë për periudhën 2026–2030 bazohet në katër boshte strategjike të zhvillimit, të cilat përbëjnë shtyllat themelore mbi të cilat ndërtohen politikat, objektivat dhe masat institucionale në fushën e kërkimit, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit.

1. *Kërkim shkencor ndërkombëtar dhe ekselencë shkencore;*
2. *Infrastrukturë dhe kapacitete kërkimore;*
3. *Kërkim shkencor i aplikuar dhe inovacion;*
4. *Rrjete kërkimore dhe mobilitet shkencor.*

Zbatimi i Strategjisë për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin 2025–2030 do të monitorohet dhe vlerësohet përmes një kornize të strukturuar institucionale, e cila bazohet në përdorimin e treguesve të matshëm të performancës (KPI) për secilin bosht strategjik dhe objektiv prioritar, në raportimin vjetor institucional të progresit të arritur, si dhe në rishikimin periodik çdo dy vjet nga strukturat drejtuese, me qëllim garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm dhe përshtatjes së strategjisë ndaj zhvillimeve të reja akademike, shkencore dhe institucionale.

Koordinimi i përgjithshëm i procesit të zbatimit do të realizohet nga Zëvendës-Rektorja për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor, në bashkëpunim të ngushtë me Sektorin e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve dhe me strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në universitet.

Ky mekanizëm koordinimi dhe monitorimi konsolidohet brenda kuadrit të organigramës zyrtare të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, e cila përcakton qartë rolet, kompetencat dhe përgjegjësitë e strukturave drejtuese, përfshirë Rektorin, Zëvendës-Rektorët dhe njësitë qendrore, si dhe modalitetet e bashkëpunimit ndërinstitucional për zbatimin efektiv të objektivave strategjike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrje
2. Konteksti dhe situata aktuale
3. Misioni, vizioni dhe vlerat në kërkim dhe inovacion
4. Vizioni strategjik
5. Boshtet, objektivat strategjike dhe linjat e veprimit

Skenari I. Kërkim shkencor ndërkombëtar dhe ekselencë shkencore

Skenari II. Infrastrukturë dhe kapacitete kërkimore

Skenari III. Kërkim shkencor i aplikuar dhe inovacion

Skenari IV. Rrjete kërkimore dhe mobilitet shkencor

Aneks

- I. Grupi i punës
- II. Metodologjia e përdorur për hartimin e strategjisë së kërkimit dhe inovacionit
- III. Monitorimi, raportimi dhe rishikimi i strategjisë
- IV. Analiza SWOT
- V. Dokumentacioni i konsultuar dhe integruar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

1. HYRJJE

Më 28 shkurt 2024, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (UV) shënoi 30-vjetorin e themelimit të tij. Gjatë këtyre viteve, ky universitet është shndërruar në një forcë të rëndësishme shtytëse të zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe kulturor të qytetit të Vlorës dhe të rajonit jugor të Shqipërisë. Njëkohësisht, ai është hapur ndaj hapësirës ndërkombëtare me synimin për t'u konsoliduar si një institucion referues në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. I rrënjosur fort në realitetin lokal, por i orientuar drejt botës, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë përfaqëson sot një aktor kyç në zhvillimin rajonal.

Që në fillimet e tij, UV i ka kushtuar një rëndësi të veçantë kërkimit shkencor dhe zhvillimit akademik. Lidhja ndërmjet cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor, dhe realitetit shoqëror e ekonomik të rajonit ka qenë baza mbi të cilën institucioni është zhvilluar. Ky kombinim faktorësh reflektohet edhe në përpjekjet e vazhdueshme për rritjen e performancës akademike, pjesëmarrjen në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në përmirësimin e pozicionimit të universitetit në rrjetet akademike dhe kërkimore.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë është gjithashtu i vetëdijshëm për rolin e tij në zhvillimin lokal dhe rajonal. Angazhimi i tij ndaj shoqërisë shprehet në ofertën e gjerë të programeve Bachelor, Master dhe Doktoratë, në përgatitjen e profesionistëve të kualifikuar për tregun e punës, si dhe në transferimin e njohurive dhe inovacionit drejt komunitetit dhe sektorëve ekonomikë. Kjo lidhje ndërmjet mësimdhënies, kërkimit dhe realitetit socio-ekonomik kontribuon në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Në kontekstin e transformimit të paradigmes ekonomike dhe shoqërore, ku njohuria dhe inovacioni janë shndërruar në faktorë kryesorë të zhvillimit, universitetet luajnë një rol qendror në krijimin e kapitalit njerëzor dhe në gjenerimin e dijes. Si institucion i arsimit të lartë publik, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë mban një përgjegjësi shoqërore në rritje, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor të vendit.

Ky Plan Strategjik synon të forcojë misionin e UV-së, të bazuar në ekselencën akademike dhe shkencore, për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve, për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të pozicionuar Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë si një qendër reference për arsimin, kërkimin dhe inovacionin në nivel kombëtar dhe rajonal.

Strategjia e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit 2025-2030 e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë (UV) përbën dokumentin kryesor orientues për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

inovative të institucionit në një kontekst të ri shoqëror, ekonomik dhe teknologjik, të karakterizuar nga transformime të thella dhe rritje e rolit të dijes si faktor kyç i zhvillimit të qëndrueshëm.

Strategjia është ndërtuar në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional 2025-2030 të UV-së, me kuadrin ligjor kombëtar për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, si dhe me prioritetet e Zonës Evropiane të Kërkimit (European Research Area – ERA) dhe politikat e Bashkimit Evropian në fushën e kërkimit dhe inovacionit.

Vizioni i kësaj strategjie është konsolidimi i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë si një universitet kërkimor dhe inovativ, me profil të dallueshëm shkencor dhe dukshmëri ndërkombëtare, i integruar në rrjetet evropiane të kërkimit dhe i angazhuar ndaj sfidave shoqërore dhe zhvillimit rajonal.

2. KONTEKSTI DHE SITUATA AKTUALE

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ofron shërbimin publik të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor përmes mësimdhënies, kërkimit dhe transferimit të njohurive, duke u siguruar anëtarëve të komunitetit universitar, organizatave dhe shoqërisë në tërësi aftësitë, idetë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të jetuar dhe punuar në një realitet që karakterizohet nga ndryshime të vazhdueshme shoqërore, ekonomike dhe teknologjike.

Në kontekstin e zhvillimit institucional, strategjia e fundit institucionale e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë është hartuar për periudhën 2017-2022, duke përfaqësuar dokumentin bazë orientues për politikat akademike, kërkimore dhe organizative të universitetit në atë fazë. Pas përfundimit të kësaj periudhe strategjike, UV përballet me nevojën për një qasje të re dhe të përditësuar, në përputhje me transformimet e arsimit të lartë në nivel kombëtar dhe evropian, si dhe me prioritetet e reja të zhvillimit socio-ekonomik të vendit.

Që nga themelimi i tij, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë i ka kushtuar një rëndësi të veçantë kërkimit shkencor si komponent thelbësor i misionit të tij akademik. Lidhja ndërmjet cilësisë së mësimdhënies, prodhimit të dijes shkencore dhe realitetit socio-ekonomik të rajonit ka qenë baza mbi të cilën institucioni është zhvilluar dhe konsoliduar. Kjo qasje synon jo vetëm avancimin akademik, por edhe rritjen e ndikimit të universitetit në zhvillimin lokal dhe rajonal, përmes ofrimit të zgjidhjeve shkencore për sfidat konkrete të shoqërisë.

Në këtë kuadër, Universiteti ka ndjekur një qasje të dyfishtë strategjike. Nga njëra anë, një pozicionim horizontal, që synon garantimin e cilësisë shkencore në shumicën e fushave të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

kërkimit, duke i bërë ato konkurruese në nivel kombëtar dhe rajonal. Nga ana tjetër, një pozicionim vertikal, që synon zhvillimin dhe konsolidimin e fushave prioritare të kërkimit, me potencial për të arritur nivele ekselence dhe njohjeje ndërkombëtare në afatmesëm dhe afatgjatë.

Në bazë të këtij vizioni, janë zhvilluar politika dhe programe institucionale që synojnë forcimin e kapaciteteve kërkimore, rritjen e pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ndërtimin e partneriteteve strategjike me universitete, qendra kërkimore, institucione publike dhe sektorin privat. Paralelisht, përfshirja e stafit akademik me profile të reja dhe të larmishme ka kontribuar në zgjerimin e fushave të kërkimit dhe në rritjen e pranisë së UV-së në rrjete dhe platforma akademike ndërkombëtare.

Duke qenë e vetëdijshme për rëndësinë themelore të burimeve njerëzore, UV synon të forcojë politikat për zhvillimin e karrierës akademike, tërheqjen dhe mbajtjen e talenteve kërkimore, si dhe krijimin e kushteve të favorshme për realizimin e veprimtarisë shkencore. Këto masa synojnë rritjen progresive të mbështetjes për kërkimin, si në aspektin e kapaciteteve njerëzore, ashtu edhe të burimeve infrastrukturore dhe financiare.

Në një kontekst më të gjerë, transformimi i shoqërisë drejt një ekonomie të bazuar në njohuri, inovacion dhe teknologji, ka rritur ndjeshëm rolin dhe përgjegjësinë shoqërore të universiteteve. Në këtë kuadër, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë synon të pozicionohet si një aktor kyç në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor të rajonit dhe të vendit, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt së ardhmes.

Partneritetet dhe profilizimi strategjik ndërkombëtar

Forcimi i ndërkombëtarizimit të veprimtarisë kërkimore të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë (UV) mbështetet gjithnjë e më shumë në tregues të jashtëm të njohur ndërkombëtarisht, të cilët reflektojnë rritjen e performancës shkencore dhe pozicionimin e universitetit në hapësirën akademike kombëtare dhe ndërkombëtare. Prodhimi shkencor i stafit akademik evidentohet përmes publikimeve të indeksuara në Scopus dhe Web of Science, të cilat janë të pasqyruara në mënyrë transparente në faqen zyrtare të universitetit dhe përfaqësojnë një tregues të drejtpërdrejtë të cilësisë dhe impaktit të kërkimit shkencor të UV-së. Në këtë kuadër, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë renditet në mënyrë të qëndrueshme ndër institucionet kërkimore më aktive në vend. Sipas Albanian National H-index Ranking, në vitin 2025 UV renditet në vendin e 8-të në rang kombëtar, duke u bazuar në H-indeksin e përgjithshëm të institucioneve shkencore në Shqipëri, i cili llogaritet mbi të dhënat e platformave shkenometrike ndërkombëtare si Scopus, Web of Science dhe Google Scholar. Ky tregues konfirmon rritjen e vazhdueshme të ndikimit shkencor të universitetit në nivel kombëtar. Ndërkombëtarizimi institucional i UV-së përforcohet gjithashtu nga pajisja me Erasmus Charter for Higher Education (ECHE) 2021–2027, e cila



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

garanton përfshirjen e universitetit në programet evropiane të mobilitetit dhe bashkëpunimit akademik, si dhe nga pjesëmarrja aktive në programin Erasmus+ për shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik.

Instrumentet kryesore për realizimin e këtij boshti përfshijnë:

- marrëveshje bilaterale dhe multilaterale kërkimore;
- pjesëmarrje në programe Horizon Europe, COST, Erasmus+;
- thithje të profesorëve vizitorë dhe ekspertëve ndërkombëtarë;
- mobilitete kërkimore për staf dhe doktorantë;
- bashkëpunime me diasporën akademike shqiptare;
- përdorim strategjik i ranking-eve dhe platformave digjitale për promovimin institucional.

Një tregues domethënës i dukshmërisë ndërkombëtare të universitetit është edhe renditja nr. 1 në botë për "Student Mobility and Openness" sipas WURI Ranking 2024, e cila vlerëson institucionet e arsimit të lartë për hapjen ndërkombëtare, mobilitetin dhe përfshirjen globale të studentëve.

Kjo renditje e pozicionon Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë si një aktor të spikatur në fushën e ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë. Po ashtu, universiteti renditet ndër institucionet më të mira shqiptare sipas Webometrics Ranking of World Universities, i cili mat praninë, dukshmërinë dhe ndikimin akademik të institucioneve në hapësirën digjitale globale.

Ky vlerësim reflekton jo vetëm performancën kërkimore, por edhe angazhimin e universitetit në promovimin e dijes dhe transparencës akademike në nivel ndërkombëtar. Në tërësi, këta tregues dëshmojnë se Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë po konsolidohet gradualisht si një institucion me dukshmëri ndërkombëtare, i mbështetur në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor, forcimin e partneriteteve strategjike dhe pjesëmarrjen aktive në rrjetet evropiane dhe globale të arsimit të lartë.

Në kuadër të këtij boshti strategjik, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë synon:

- të forcojë pozicionimin e tij si partner i besueshëm kërkimor në hapësirën evropiane të kërkimit (ERA);
- të rrisë pjesëmarrjen aktive në konsorciume ndërkombëtare kërkimore;
- të zhvillojë profile të dallueshme shkencore (research niches) në fushat e specializimit;
- të konsolidojë brand-in institucional të UV-së si qendër ekspertize rajonale dhe ndërkombëtare.

Qasje të reja ndaj sfidave të reja

Konteksti i jashtëm po përjeton ndryshime të thella në të gjitha nivelet: në nivel sistematik, organizativ dhe në proceset e funksionimit. Realiteti aktual është thelbësisht i ri dhe kërkon



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË SENATI AKADEMIK

përgjigje të reja. Për këtë arsye, një pjesë e konsiderueshme e transformimeve që po ndodhin kërkojnë reagime të reja nga sistemi shkencor, teknologjik dhe i inovacionit, dhe në mënyrë të veçantë nga universitetet, si aktorë kyç të zhvillimit shoqëror dhe ekonomik.

Këto ndryshime shoqërohen me sfida të reja lokale dhe globale, të cilat janë gjithnjë e më të ndërlikura me njëra-tjetrën. Nga perspektiva e sfidave globale, një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet shtatëmbëdhjetë Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) të miratuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara në vitin 2015, të cilat përbëjnë një kuadër referues ndërkombëtar për politikat e zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor.

Në këtë kontekst, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë duhet të pranojë dhe të forcojë angazhimin e tij ndaj shoqërisë, duke luajtur një rol proaktiv në nxitjen e kërimit shkencor që ofron njohuri, zgjidhje dhe evidenca për përballimin e këtyre sfidave globale dhe lokale.

Modelet tradicionale të gjenerimit dhe transferimit të dijes po transformohen gradualisht drejt sistemeve më të hapura dhe bashkëpunuese, të njohura si Open Science dhe Open Innovation, ku bashkëkrijimi i njohurive përbën një element thelbësor të procesit dhe një strukturë e re për krijimin e vlerës shkencore. Këto modele synojnë të rrisin përfitimin shoqëror të kërimit dhe të sigurojnë një ndikim më të gjerë dhe më gjithëpërfshirës.

Në të njëjtën kohë, komuniteti shkencor i së tashmes dhe i së ardhmes, si dhe institucionet akademike, duhet të zhvillojnë kompetenca dhe funksione të reja. Disa prej tyre janë të brendshme, si integrimi ndërdisiplinor dhe rritja e bashkëpunimit ndërmjet fushave të ndryshme të dijes, ndërsa të tjera janë të jashtme, si ndërtimi i një kulture të re ndërveprimi ndërmjet sistemit shkencor dhe atij shoqëror.

Një dimension i rëndësishëm i këtij transformimi është edhe avancimi drejt Kërimit dhe Inovacionit të Përgjegjshëm (Responsible Research and Innovation - RRI), i cili nënkupton përfshirjen aktive të shoqërisë në proceset kërkimore, promovimin e shkencës së hapur, respektimin e parimeve etike dhe garantimin e barazisë gjinore, ndër të tjera.

Plani Strategjik i Kërimit Shkencor dhe Inovacionit i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë është konceptuar pikërisht në këtë realitet të ri, ku njohuria është shndërruar në forcën kryesore shtytëse të zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, dhe synon të orientojë universitetin drejt një roli gjithnjë e më aktiv në shërbim të shoqërisë. Ky plan do të udhëheqë strategjitë dhe linjat e veprimit të UV-së në vitet në vijim, me synimin për ta konsoliduar atë si një universitet kërkimor dhe inovativ, konkurrues në nivel ndërkombëtar dhe i angazhuar ndaj sfidave bashkëkohore të shoqërisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË SENATI AKADEMIK

3. MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT NË KËRKIM DHE INOVACION

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (UV) është krijuar si institucion publik i arsimit të lartë në shërbim të shoqërisë shqiptare, mbi bazën e traditës akademike dhe strukturave ekzistuese arsimore. Që në fillimet e tij, synimi kryesor ka qenë vendosja e dijes në shërbim të shoqërisë, për të kontribuar në zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të qytetit të Vlorës, rajonit dhe më gjerë, në një kontekst që ka njohur transformime të rëndësishme ndër vite.

Misioni

Cilat janë detyrat tona kryesore në kërkim dhe inovacion?

Të kontribuojmë në përmirësimin e mirëqenies së shoqërisë dhe në zhvillimin e qëndrueshëm, veçanërisht në nivel lokal dhe rajonal, përmes gjenerimit, zhvillimit dhe transferimit të njohurive shkencore, duke mbështetur politikat publike, sektorët ekonomikë dhe zhvillimin e komunitetit.

Vizioni

Cili është vizioni ynë në kërkim dhe inovacion?

Të konsolidohemi si një universitet kërkimor dhe inovativ me dukshmëri ndërkombëtare, i lidhur me rrjetet më të rëndësishme akademike dhe shkencore në të gjitha fushat e dijes, dhe të shndërrohemi në një pikë reference kombëtare dhe rajonale për kërkimin shkencor dhe inovacionin. UV synon të jetë një universitet që formon individë të kualifikuar, zhvillon kërkim të përgjegjshëm dhe inovacion konkurrues, është i angazhuar ndaj mjedisit dhe kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit dhe të vendit.

Vlerat

Çfarë përfaqësojmë?

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë përfaqëson një komunitet akademik dhe kërkimor të hapur ndaj ndryshimit, me aftësi të lartë përshtatjeje dhe reagimi ndaj sfidave bashkëkohore, ku në qendër vendosen njeriu dhe vlerat e bashkëpunimit, besimit, përgjegjësisë së përbashkët, integritetit akademik dhe shërbimit ndaj shoqërisë.

5. VIZIONI STRATEGJIK

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (UV) synon të arrijë një sërë objektivash strategjike në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit, të cilët përbëjnë bazën e zhvillimit të tij afatgjatë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

- Të arrijë nivele të ekselencës shkencore, mbi të cilat të ndërtohen procese të avancuara të mësimdhënies dhe të nxënies, duke u ofruar studentëve formimin më të lartë cilësor dhe duke kontribuar në zhvillimin e tyre si qytetarë dhe profesionistë të përgjegjshëm.
- Të gjenerojë, transferojë dhe socializojë dijen, me qëllim mbështetjen e progresit të qëndrueshëm të shoqërisë. Kërkimi, transferimi i njohurive dhe mësimdhënia janë procese të pandashme, ndaj studentët në të gjitha nivelet e studimit duhet të pajisen me kompetencat e nevojshme dhe të përfshihen aktivisht në veprimtarinë kërkimore dhe inovative.
- Të pranojë dhe të ushtrojë rolin e tij si motor i zhvillimit njerëzor të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm, veçanërisht në kontekstin social, kulturor dhe ekonomik të qytetit të Vlorës dhe rajonit, përmes kërkimit të pavarur, si dhe transmetimit dhe aplikimit të njohurive. Njëkohësisht, UV synon të kontribuojë edhe në sfidat globale që prekin shoqërinë dhe planetin.
- Të shfrytëzojë universalitetin e dijes, që është thelbësor për natyrën e universitetit, si mjet komunikimi dhe dialogu ndërmjet popujve, duke nxitur në maksimum ndërkombëtarizimin e veprimtarisë universitare.

Duke marrë në konsideratë dinamikën dhe fleksibilitetin institucional, bashkëpunimet e jashtme dhe vullnetin për t'u përballur me sfidat në shërbim të shoqërisë, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë synon të konsolidohet në vitet në vijim si një mjedis lider në kërkim dhe inovacion, i cili integron modele të reja bashkëkohore për gjenerimin dhe transferimin e njohurive.

Ekosistemet e gjalla përfaqësojnë struktura funksionale komplekse, të afta për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve të pasigurta, duke vlerësuar diversitetin individual dhe duke e lidhur atë me mjedisin lokal dhe global. Në këtë kuptim, UV synon të zhvillohet si pjesë e një ekosistemi kërkimor dhe inovativ, ku:

- Kërkimi dhe inovacioni do të orientohen drejt tematikave me rëndësi shkencore dhe shoqërore, ku universiteti dhe partnerët e tij mund të kenë ndikim të ndjeshëm në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Talenti, kreativiteti dhe aftësitë profesionale do të nxiten përmes aleancave të brendshme dhe të jashtme, në kuadër të proceseve të bashkëkrijimit dhe bashkëinovacionit.
- Departamentet dhe njësitë kërkimore me performancë të lartë do të mbështeten përmes zhvillimit të kulturës organizative, lidhshpimit akademik, asistencës teknike dhe drejtuese, si dhe sigurimit të infrastrukturës së nevojshme.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë synon të maksimizojë ndikimin e tij shoqëror, ekonomik dhe kulturor përmes veprimtarisë kërkimore dhe inovative, të bazuar në ekselencën shkencore dhe të matur edhe përmes impaktit të saj, duke kontribuar drejtpërdrejt në përballimin e sfidave të shoqërisë dhe në forcimin e sektorëve produktivë ku rajoni ka potencial zhvillimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Sfidat shoqërore

Sfidat kryesore ndaj të cilave ky Plan Strategjik synon të japë përgjigje janë:

- Përmirësimi i mirëqenies së shoqërisë, nëpërmjet zhvillimit të politikave dhe zgjidhjeve të bazuara në evidencë shkencore.
- Zhvillimi i qëndrueshëm, në dimensionin ekonomik, social dhe mjedisor, duke promovuar modele inovative që kontribuojnë në rritjen ekonomike të balancuar, përfshirjen sociale dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Rigjallërimi i qyteteve dhe i rajonit, përmes nxitjes së inovacionit, transferimit të njohurive dhe përfshirjes aktive të universitetit në zhvillimin territorial dhe komunitar.

Fokusimi në këto sfida dhe objektiva u mundëson fushave të ndryshme shkencore të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë të përfshihen në mënyrë aktive në identifikimin dhe ndërtimin e fushave të ekselencës, duke nxitur kështu zhvillimin e projekteve ndërdisiplinore dhe krijimin e zgjidhjeve të integruara për problematikat komplekse të shoqërisë bashkëkohore.

Sektorët prodhues të specializuar të rajonit

Në bazë të strategjisë fillestare të përcaktuar në planin e parë të kërkimit shkencor, përputhur me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, si dhe me legjislacionin kombëtar për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, identifikohen sektorët e mëposhtëm të specializimit rajonal që lidhen drejtpërdrejt me profilin akademik dhe kërkimor të UV-së: ekonomi dhe menaxhim, shëndetësi dhe shërbime shëndetësore, shkenca humane dhe edukimi, si dhe teknologji dhe shkenca teknike. Fokusimi mbi këta sektorë prodhues prioritarë synon të forcojë vizionin e rajonit si një forcë shtytëse për zhvillimin e qëndrueshëm dhe për inovacionin ekonomik dhe social, duke shfrytëzuar funksionet themelore të UV-së në kërkimin shkencor dhe zhvillim, sipas dispozitave të statutit dhe rregulloreve për veprimtarinë shkencore dhe ndërkombëtarizimin e veprimtarisë së institucionit. Gjithashtu, dinamikat socio-ekonomike të rajonit mund të çojnë në shfaqjen e sektorëve të rinj të specializimit në të ardhme.

Ekselencja shkencore

Nëpërmjet ekselencës shkencore, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë kontribuon në avancimin e dijes dhe gjeneron mundësi të reja që ndihmojnë në rritjen e kapacitetit të sektorit prodhues për të inovuar dhe për të qenë konkurrues, si dhe për t'u përballur me sfidat shoqërore të trajtuara në këtë plan. Arritja e ekselencës shkencore kuptohet si një proces i përmirësimit të vazhdueshëm, i cili forcon lidhësinë shkencore dhe njohjen ndërkombëtare në fushat e specializimit. Në mbështetje të politikave institucionale për garantimin dhe rritjen e ekselencës shkencore, kjo Strategji e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit 2025–2030 synon të reflektojë angazhimin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë për të rritur cilësinë, ndikimin dhe relevancën shoqërore të veprimtarisë kërkimore, si dhe për të forcuar rolin e inovacionit si komponent thelbësor i kërkimit shkencor, duke shfrytëzuar instrumentet institucionale të universitetit dhe duke



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

zhvilluar bashkëpunime të strukturuar me bizneset, institucionet publike dhe aktorët socio-ekonomikë të rajonit, me qëllim ndërtimin e një sistemi funksional rajonal të kërkimit, dijes dhe inovacionit, i cili kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm dhe në përmirësimin e mirëqenies së komunitetit.

Tabela përmbledhëse e treguesve strategjikë

Boshti strategjik	KPI kryesor
<i>Skenari I - Ekselencë dhe ndërkombëtarizim</i>	Publikime Scopus/WoS, H-index, Projekte Horizon
<i>Skenari II – Infrastrukturë</i>	Laboratorë të akredituar, Repository, Revista UVSJ me faktor impakti të lartë
<i>Skenari III – Inovacion</i>	Patenta, spin-off, kontrata kërkimi
<i>Skenari IV – Rrjete dhe mobilitet</i>	Mobilitete, marrëveshje, ekspertë të ftuar

5. BOSHTET, OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE LINJAT E VEPRIMIT

Strategjia e Kërkimit Shkencor e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë bazohet në katër skenarë zhvillimi:

- (I) Ekselencë dhe ndërkombëtarizim shkencor,
- (II) Infrastrukturë dhe kapacitete kërkimore,
- (III) Kërkim i aplikuar dhe inovacion,
- (IV) Rrjete dhe mobilitet kërkimor, të cilët janë të lidhur drejtpërdrejt me objektivat kombëtare të AKKSHI dhe prioritetet e Zonës Europiane të Kërkimit.

5.1 Roadmap i zbatimit 2025-2030

Roadmap-i i zbatimit paraqet planifikimin kohor të objektivave strategjike kryesore të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë për periudhën 2025-2030, duke siguruar një qasje progresive dhe të matshme për realizimin e tyre.

Objektivi strategjik	2025	2027	2030
<i>Publikime Scopus/WoS</i>		+20%	+50%
<i>Projekte Horizon/COST</i>		+20%	+50%
<i>Laboratorë të akredituar</i>	0	+50%	+100%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

<i>Mobilitete kërkimore</i>		+30%	+60%
<i>Spin-off akademike</i>	0	+	++
<i>% Open Access</i>	10%	30%	60%

Roadmap-i do të shërbejë si instrument bazë për monitorimin vjetor të progresit dhe për përditësimin periodik të objektivave strategjike, në funksion të performancës institucionale dhe kushteve të mjedisit të jashtëm.

LIDHJA E SKENARËVE ME OBJEKTIVAT KOMBËTARE (AKKSHI)

	<i>Skenarët UV</i>
<i>Cilësi dhe ekselencë shkencore</i>	Skenari I
<i>Infrastrukturë kërkimore</i>	Skenari II
<i>Inovacion dhe transferim teknologjie</i>	Skenari III
<i>Bashkëpunim dhe rrjete</i>	Skenari IV
<i>Zgjidhje problemesh reale</i>	Skenari III
<i>Integrim në ERA</i>	Skenari I & IV

SKENARI I: KËRKIM SHKENCOR NDËRKOMBËTAR DHE EKSELENCA
SHKENCORE

Qëllimi Strategjik

Rritja e cilësisë dhe ndërkombëtarizimit të kërkimit shkencor përmes publikimeve, projekteve dhe rrjeteve kërkimore europiane.

Objektivat 1.1

- Pjesëmarrja në konsorciume/aleanca kërkimore ndërkombëtare
- Rritja e publikimeve në revista Scopus/WoS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

- Pjesëmarrje aktive në projekte Horizon, COST, Erasmus+
- Organizimi i konferencave dhe workshop-eve shkencore
- Fuqizimi i revistës UniVlora Scientific Journal

Linjat e kërkimit

1. Pjesëmarrja në konsorciume kërkimore ndërkombëtare

- Kërkime mbi modele efektive të bashkëpunimit ndëruniversitar dhe ndërdisiplinor në nivel evropian.
- Studime mbi mekanizmat e ndërtimit dhe menaxhimit të konsorciumeve kërkimore ndërkombëtare.
- Analiza e praktikave më të mira për rritjen e rolit të universiteteve periferike në projekte të mëdha kërkimore.

2. Rritja e publikimeve në revista të indeksuara Scopus / Web of Science

- Kërkime mbi cilësinë e prodhimit shkencor, standardet e publikimit dhe etikën akademike.
- Studime mbi strategjitë për rritjen e citueshmërisë dhe impaktit shkencor të publikimeve.
- Analiza bibliometrike e performancës kërkimore të stafit akademik dhe njërive kërkimore.

3. Pjesëmarrje aktive në projekte Horizon Europe, COST dhe Erasmus+

- Kërkime mbi politikat evropiane të kërkimit, inovacionit dhe arsimit të lartë.
- Studime mbi ndërlidhjen e kërkimit shkencor me zhvillimin rajonal, inovacionin dhe transferimin e njohurive.
- Analiza e ndikimit të projekteve ndërkombëtare në kapacitetet kërkimore institucionale.

4. Organizimi i konferencave dhe workshop-eve shkencore ndërkombëtare

- Kërkime mbi rolin e eventeve shkencore në ndërtimin e rrjeteve kërkimore dhe bashkëpunimeve afatgjata.
- Studime mbi format inovative të konferencave akademike dhe shkëmbimin e njohurive.
- Analiza e ndikimit të konferencave në rritjen e dukshmërisë ndërkombëtare të institucionit.

5. Fuqizimi i UniVlora Scientific Journal

- Kërkime mbi politikat editoriale, menaxhimin e revistave shkencore dhe standardet ndërkombëtare të indeksimit.
- Studime mbi ndërkombëtarizimin e bordeve editoriale dhe procesin e peer-review.
- Analiza e rolit të revistës institucionale në promovimin e kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Tregues performance (KPI)

Treguesit e Performancës për Skenarin I përfshijnë: numrin e publikimeve shkencore të indeksuara në Scopus dhe Web of Science; H-indeksin institucional; numrin e projekteve kërkimore ndërkombëtare të fituara (Horizon Europe, COST, Erasmus+); numrin e aplikimeve në thirrje konkurruese ndërkombëtare; numrin e konsorciumeve kërkimore ndërkombëtare ku Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë është partner ose koordinator; numrin e konferencave dhe workshop-eve shkencore ndërkombëtare të organizuara; si dhe numrin e artikujve të botuar në revistën institucionale *UniVlora Scientific Journal/Buletin Shkencor*.

- Numri i publikimeve Scopus/WoS / vit
- H-index institucional
- Numri i projekteve Horizon/COST të fituara
- Numri i konferencave ndërkombëtare
- Numri artikuj në UniVlora Scientific Journal/Buletin

SKENARI II: INFRASTRUKTURË DHE KAPACITETE KËRKIMORE

Qëllimi Strategjik

Ndërtimi i një ekosistemi modern kërkimor përmes laboratorëve, revistave shkencore. infrastrukturës digjitale dhe kapaciteteve njerëzore.

Objektivat 2.1

- Akreditimi dhe licencimi i laboratorëve kërkimorë
- Çertifikime ISO për njësi kërkimore
- Indeksimi i UniVlora Scientific Journal në Scopus, WoS, PubMed
- Zgjerimi i UniVlora Research Repository
- Sisteme bibliometrike për matjen e performancës
- Trajnime për metodologji kërkimi

Linjat e kërkimit

Akreditimi dhe licencimi i laboratorëve kërkimorë

- Studime mbi standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për akreditimin e laboratorëve kërkimorë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

- Kërkime mbi menaxhimin e cilësisë laboratorike, sigurinë dhe etikën në kërkim shkencor.
- Modele të organizimit dhe funksionimit të laboratorëve universitarë kërkimorë sipas praktikave më të mira evropiane.
- 2. Çertifikimet ISO për njësi kërkimore**
 - Kërkime mbi implementimin e standardeve ISO (ISO 9001, ISO 17025, ISO 21001) në institucione të arsimit të lartë.
 - Analiza e ndikimit të sistemeve të menaxhimit të cilësisë në performancën kërkimore dhe inovacion.
 - Studime krahasuese mbi praktikatat e çertifikimit në universitete evropiane dhe rajonale.
- 3. Indeksimi i *UniVlora Scientific Journal* në Scopus, Web of Science dhe PubMed**
 - Studime mbi politikat editoriale, etikën e publikimit dhe standardet ndërkombëtare të revistave shkencore.
 - Kërkime mbi rritjen e cilësisë së publikimeve, citueshmërisë dhe impaktit shkencor.
 - Analiza bibliometrike dhe scientometrike e prodhimit shkencor institucional dhe ndërkombëtar.
- 4. Zgjerimi i *UniVlora Research Repository***
 - Kërkime mbi Open Science, Open Access dhe menaxhimin e të dhënave kërkimore (Research Data Management).
 - Modele për arkivimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e prodhimit shkencor institucional.
 - Studime mbi ndërveprueshmërinë e repositorëve institucionalë me platformat ndërkombëtare kërkimore.
- 5. Sisteme bibliometrike për matjen e performancës kërkimore**
 - Zhvillimi dhe aplikimi i indikatorëve bibliometrikë dhe altmetrikë për vlerësimin e performancës kërkimore.
 - Kërkime mbi politikat institucionale të vlerësimit të stafit akademik dhe njërive kërkimore.
 - Analiza e përdorimit të sistemeve të inteligjencës së të dhënave për vendimmarrje strategjike në kërkim shkencor.

Tregues të performancës (KPI)

Treguesit e Performancës për Skenarin II përfshijnë: numrin e laboratorëve të akredituar dhe të modernizuar; numrin e certifikimeve ISO për njësitë kërkimore; ekzistencën dhe përdorimin e *UniVlora Research Repository*; përqindjen e publikimeve Open Access; numrin e stafit dhe doktorandëve të trajnuar në metodologji kërkimi; ekzistencën e sistemit bibliometrik institucional dhe raportimin vjetor të performancës kërkimore; si dhe buxhetin vjetor të dedikuar për infrastrukturën kërkimore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

1. Infrastrukturë laboratorike

- Numri i laboratorëve të akredituar / licencuar
- Numri i laboratorëve të modernizuar
- Përqindja e pajisjeve laboratorike të rinovuara
- Numri i certifikimeve ISO (ISO 9001, ISO 17025, etj.)

2. Infrastrukturë digjitale kërkimore

- Ekzistenca e UniVlora Research Repository (po/jo)
- Nr. publikimeve të depozituara në repository
- % e publikimeve Open Access
- Nr. databazave shkencore me akses institucional

3. Kapacitete njerëzore kërkimore

- Nr. stafit akademik të trajnuar në metodologji kërkimi
- Nr. trajnimeve për shkrim shkencor dhe menaxhim projektsh
- Nr. doktorandëve të përfshirë në projekte kërkimore
- Nr. stafit të certifikuar në menaxhim projektsh (Horizon/IPA)

4. Performancë dhe monitorim shkencor

- Ekzistenca e sistemit bibliometrik institucional
- Raport vjetor i performancës kërkimore (po/jo)
- Nr. indikatorëve të monitoruar (publikime, projekte, citime)
- Frekuenca e raportimit (vjetor / semestral)

5. Financim dhe burime

- Buxheti vjetor për infrastrukturë kërkimore
- Shuma e fondeve të investuara në pajisje
- Nr. projekteve të infrastrukturës të financuara (AKKSHI/BE)
- % e buxhetit institucional për kërkim

	KPI	2025	2030
1	Laboratorë të akredituar	1 (proces)	5
2.	Publikime në repository	0	500
3.	Staf i trajnuar	20	80
4.	% Open Access	10%	60%
5.	Buxhet kërkim	2%	5%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

SKENARI III: KËRKIM SHKENCOR I APLIKUAR DHE INOVACION

Qëllimi Strategjik

Orientimi i veprimtarisë kërkimore të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë drejt zgjidhjes së problemeve reale shoqërore dhe ekonomike, përmes zhvillimit të kërkimit të aplikuar dhe forcimit të mekanizmave të transferimit të teknologjisë, në bashkëpunim me sektorin publik, privat dhe aktorët e inovacionit, me synim rritjen e ndikimit shoqëror dhe ekonomik të

Objektivat 3.1

universitetit.

- projekte pilot me bashki/industri
- studime impakti për politika publike
- patenta / prototipe
- spin-off akademike
- kontrata kërkimi me biznese

Linjat e kërkimit

- Mjedisi & biodiversiteti
- Bujqësia & bioteknologjia
- Shëndeti & mjekësia
- TIK & inteligjenca artificiale
- Uji dhe energjia
- Digjitalizimi & tranzicioni jeshil
- Shkencat sociale & humane

Treguesit e performances (KPI)

Nr.	Tregues performance
1	Projekte kërkimore të aplikuara me bashki/biznese
2.	Kontrata kërkimi me institucione publike/privat
3.	Studime impakti për politika publike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

4.	Patenta / prototipe të zhvilluara
5.	Spin-off dhe start-up akademike të krijuara
6.	Produkte ose shërbime inovative të transferuara
7.	Projekte Universitet-Biznes (AKKSHI/IPA)
8.	Të ardhura nga kontrata kërkimi dhe shërbime

SKENARI IV: RRJETE KËRKIMORE DHE MOBILITET SHKENCOR

Qëllimi Strategjik

Integrimi i stafit dhe doktorantëve në rrjete kërkimore europiane.

Objektivat 4.1

- Mobilitete kërkimore COST, Marie Curie
- Thithje ekspertësh ndërkombëtarë
- Mentorim për kërkuesit e rinj
- Mobilitet kërkimor
- Rrjete shkencore
- Bashkëpunime me diaspora akademike
- Mentorim dhe zhvillim karriere

Linjat e kërkimit

- Promovimi i rezultateve kërkimore në media dhe platforma digjitale;
- Krijimi i podcast-eve, revistave dhe portaleve shkencore;
- Organizimi i eventeve publike shkencore (open days, science cafés);
- Forcimi i brandit institucional të UV-së si qendër ekspertize.

Treguesit e Performancës (KPI)

Nr.	Tregues performance
1.	Marrëveshje dhe partneritete kërkimore ndërkombëtare aktive
2.	Rrjete kërkimore europiane ku UV është anëtar (COST, rrjete tematike)
3.	Mobilitete kërkimore për staf akademik
4.	Mobilitete kërkimore për doktorantë
5.	Kërkues dhe ekspertë ndërkombëtarë të ftuar në UV
6.	Programe mentorimi për kërkuesit e rinj
7.	Bashkëpunime me diasporën akademike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

8. Evente shkencore publike dhe aktivitete promovuese

ANEKSET

ANEKS I

I. GRUPI I PUNËS

Frosina Londo	Zëvendësrektore për kërkimin shkencor
Artemida Luçaj	Përgjegjëse e sektorit të Kërkimit Shkencor & Projekteve
Rezarta Sinanaliaj	Specialiste projektesh
Miranda Pajo	Specialiste e aktiviteteve shkencore
Erik Kushta	Student

II. METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR HARTIMIN E STRATEGJISË SË
KËRKIMIT DHE INOVACIONIT

Hartimi i Strategjisë së Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit 2025-2030 të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë është realizuar mbi bazën e një metodologjie të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse, e cila synon të sigurojë koherencë të plotë me Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional 2025-2030, si dhe përputhshmëri me kuadrin ligjor kombëtar dhe politikat evropiane në fushën e arsimit të lartë, kërkimit dhe inovacionit. Procesi i hartimit është mbështetur në analizën e dokumenteve strategjike dhe normative kombëtare dhe evropiane, në konsultimin me strukturat drejtuese, fakultetet, departamentet dhe njësitë kërkimore të universitetit, si dhe në përdorimin e analizës SWOT për identifikimin e kapaciteteve të brendshme dhe sfidave të mjedisit të jashtëm. Në të njëjtën kohë, procesi është mbështetur edhe në analizën e treguesve sasiore të performancës kërkimore të universitetit, përfshirë numrin e publikimeve të indeksuara në Scopus dhe Web of Science, pjesëmarrjen në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, mobilitetet akademike, H-indeksin institucional dhe burimet financiare për kërkimin shkencor, me qëllim ndërtimin e objektivave dhe treguesve të performancës (KPI) mbi baza reale dhe të matshme. Strategjia është ndërtuar gjithashtu duke u mbështetur në benchmarking me praktikatat



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

më të mira evropiane, përmes analizës dhe krahasimit të strategjive të kërkimit dhe inovacionit të universiteteve partnere në Bashkimin Evropian dhe rajon, me synim përafrimin e politikave institucionale të UV-së me standardet e Zonës Evropiane të Kërkimit (ERA).

Një komponent i rëndësishëm i metodologjisë ka qenë edhe përfshirja e aktorëve të jashtëm (stakeholders), përfshirë institucione publike, biznese, organizata dhe partnerë akademikë, me qëllim orientimin e veprimtarisë kërkimore drejt nevojave reale të zhvillimit lokal dhe rajonal. Strategjia është ndërtuar mbi qasjen me skenarë zhvillimi të përcaktuar në Planin Institucional (Ndërkombëtarizimi, Universitet SMART, Leader Profesional dhe UV si Qendër Zhvillimi Rajonal), duke siguruar gjurmueshmëri dhe koherencë strategjike ndërmjet dokumenteve institucionale. Në të njëjtën kohë, metodologjia është orientuar drejt ndikimit shoqëror të kërkimit dhe inovacionit, duke promovuar parimet e Open Science, Responsible Research and Innovation (RRI) dhe bashkëpunimit me aktorët e jashtëm, me qëllim që kërkimi shkencor të shërbejë si instrument zhvillimi ekonomik, social dhe territorial për rajonin dhe shoqërinë në tërësi.

ANEKSI II – MATRICA E MENAXHIMIT TË RREZIKUT

Matrica e menaxhimit të rrezikut

Rreziku kryesor	Probabiliteti	Ndikimi	Masa parandaluese
Mungesë fondesh për kërkim	Lartë	Lartë	Diversifikim burimesh (Horizon, IPA, AKKSHI)
Brain drain i stafit	Mesëm	Lartë	Incentiva financiare dhe karrierë
Kapacitete të ulëta kërkimore	Mesëm	Mesëm	Trajnime dhe mentorim
Infrastrukturë e pamjaftueshme	Mesëm	Lartë	Investime dhe projekte infrastrukturore
Ndryshime politike/ligjore	Ulët	Mesëm	Përshtatje strategjike

III. MONITORIMI, RAPORTIMI DHE RISHIKIMI I STRATEGJISË

Në zbatim të kësaj Strategjie, monitorimi, vlerësimi dhe raportimi i progresit do të realizohen në mënyrë të strukturuar dhe periodike nga strukturat përkatëse institucionale, në përputhje me kompetencat dhe detyrat funksionale të miratuara në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë. Konkretisht, përgjegjësinë kryesore për koordinimin dhe ndjekjen e zbatimit të Strategjisë e mban Zëvendës-Rektori për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kërkim-Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me të Tretët, përmes Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, i cili siguron mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, monitorimin e treguesve të performancës (KPI), si dhe përgatitjen e raporteve periodike të progresit.




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Procesi i raportimit institucional mbështetet gjithashtu nga Drejtoria e Shërbimeve Ndihmëse Akadematike, përmes Sektorit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit, si dhe nga strukturat përgjegjëse për raportim dhe statistika, të cilat garantojnë përputhshmërinë e zbatimit të Strategjisë me standardet e sigurimit të cilësisë, kërkesat e ASCAL dhe kuadrin ligjor kombëtar në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Raportet vjetore mbi progresin e zbatimit të Strategjisë për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin i paraqiten Rektoratit dhe Senatit Akademik, në cilësinë e organeve më të larta drejtuese dhe vendimmarrëse të institucionit, të cilat ushtrojnë funksionin e mbikëqyrjes strategjike dhe miratojnë masat korrigjuese në rast të devijimeve nga objektivat dhe treguesit e përcaktuar.



Rishikimi periodik

Rishikimi i strategjisë do të realizohet në mënyrë periodike çdo dy vjet, përmes një procesi të strukturuar vlerësimi të brendshëm, i cili përfshin analizën e arritjes së KPI-ve, konsultimin me njësitë akademike dhe aktorët e jashtëm, si dhe miratimin e rekomandimeve për përmirësim nga Senati Akademik.

Grup Monitorimi

Për zbatimin operacional të strategjisë mund të ngrihet një Grup i Përhershëm Monitorimi, i përbërë nga përfaqësues të Rektoratit, Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, Sektorit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe përfaqësues të fakulteteve, i cili do të mbështesë procesin e monitorimit dhe do të propozojë masa përmirësuese.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Menaxhimi

Monitorimi i treguesve të performancës do të mbështetet edhe nga zhvillimi gradual i një sistemi digjital (dashboard institucional), i cili mundëson mbledhjen, vizualizimin dhe analizën në kohë reale të të dhënave kërkimore.

Menaxhimi i rrezikut

Gjatë zbatimit të strategjisë do të aplikohet një qasje e menaxhimit të rrezikut (risk management), e cila synon identifikimin dhe adresimin e rreziqeve kryesore që lidhen me financimin, burimet njerëzore, kapacitetet infrastrukturore dhe ndryshimet në politikat publike.

Lidhja me planifikimin buxhetor

Zbatimi i objektivave strategjikë do të mbështetet përmes planifikimit vjetor buxhetor të universitetit, duke siguruar lidhjen ndërmjet prioritetëve strategjike të kërkimit dhe alokimit të burimeve financiare në nivel institucional, në përputhje me buxhetin vjetor dhe planifikimin afatmesëm të zhvillimit të universitetit.

Transparenca dhe komunikimi publik

Rezultatet e monitorimit dhe raportimit vjetor do të publikohen në faqen zyrtare të universitetit dhe në raportet institucionale, në kuadër të politikave të transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së hapur.

Ndikimi shoqëror

Vlerësimi i strategjisë nuk do të kufizohet vetëm në tregues sasiorë, por do të përfshijë edhe analizën e ndikimit shoqëror, ekonomik dhe territorial të veprimtarisë kërkimore të universitetit.

Boshti UV	ERA Priority
Partneritete dhe profilizim ndërkombëtar	Deepening a truly functioning ERA
Infrastrukturë kërkimore	Research infrastructures
Kërkim i aplikuar	Knowledge valorisation
Rrjete dhe mobilitet	Researchers mobility



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

IV. ANALIZA SWOT - KËRKIMI SHKENCOR DHE INOVACIONI (UV 2025–2030)

PIKAT E FORTA (Strengths)	PIKAT E DOBËTA (Weaknesses)
Strukturë organizative funksionale për menaxhimin e kërkimit dhe projekteve	Numër i ulët i programeve të studimit në gjuhë të huaj
Staf akademik i kualifikuar me grada shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare	Numër i kufizuar i programeve të përbashkëta ndërkombëtare
Pjesëmarrje aktive në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare (Erasmus+, IPA, Horizon)	Infrastrukturë kërkimore dhe laboratorike e pamjaftueshme
Marrëdhënie të konsoliduara me institucione publike dhe sektorin privat	Mungesë financimi të qëndrueshëm për kërkimin shkencor
Bashkëpunime intensive me universitete të BE-së dhe rajonit	Nivel i ulët i aplikimeve në projekte Horizon Europe
Akses në programe europiane si EUSAIR dhe ekonomi blu	Aftësi të kufizuara në shkrim shkencor dhe menaxhim projektsh
Përdorim në rritje i teknologjisë digjitale në menaxhim dhe mësimdhënie	Rrjedhje e stafit të kualifikuar drejt institucioneve të tjera
Politika institucionale për cilësi dhe vlerësim akademik	Pajisje shkencore dhe laboratorike të amortizuara
Diversitet i fushave kërkimore sipas profileve të katër fakulteteve	Ndërdisciplinaritet i dobët ndërmjet fakulteteve
Pozicion gjeografik strategjik dhe potencial rajonal	Numër i ulët studentësh të përfshirë në kërkim shkencor
MUNDËSITË (Opportunities)	KËRCËNIMET (Threats)
Thirrje financimi nga BE (Horizon Europe, COST, Erasmus+, IPA)	Reduktim i fondeve publike për arsimin dhe kërkimin
Politikat kombëtare për Smart Specialisation	Konkurrencë e fortë nga universitete të tjera
Bashkëpunime me industri, turizëm, shëndetësi, ekonomi blu	Brain drain i kërkuesve të rinj
Open Science dhe digjitalizimi	Plakje e stafit akademik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Rritja e kërkesës për studime të aplikuara rajonale	Mungesë e stafit të ri kërkimor
Ranking-e ndërkombëtare dhe benchmarking	Mungesë e kulturës së inovacionit në biznes
Programet për Gender Equality, Green Deal	Paqëndrueshmëri ekonomike dhe politike
Zhvillimi i start-up dhe spin-off universitare	Varësi nga tarifat e studentëve
Partneritete me bashki dhe institucione publike	Ulje e interesit të maturantëve

V. DOKUMENATACIONI I KONSULTUAR DHE INTEGRUAR

Dokumente kombëtare

1. Ministria e Arsimit dhe Sportit (2023). *Draft Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030*, Tiranë.
2. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (2015). *Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor"*.
3. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit – AKKSHI. *Programet kombëtare të financimit për kërkimin dhe inovacionin*.

Dokumente institucionale UV

4. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (2025). *Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2025–2030*.
5. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (2022). *Strategjia e Ndërkombëtarizimit 2022–2027*.
6. Statuti dhe Rregulloret e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Dokumente evropiane / ndërkombëtare

7. European Commission (2021). *Horizon Europe Framework Programme 2021–2027*.
8. European Commission. *European Research Area (ERA) Policy Agenda*.
9. United Nations (2015). *Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development (SDGs)*.
10. OECD. *University Research and Innovation Policy Frameworks*.